



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1496/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4., kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Kompania e Avokatëve “Arbëresh”, rr. “Brigada” nr.153, Diamond Residence, Hajvali – Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.653/22 të datës 20.09.2023, me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.653/22 i datës 20.09.2023, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit përmbartimor P.nr.78/21 datës 04.02.2021 i lejuar nga përmbartuesi privat, dhe Mbetet në fuqi Urdhri përmbartimor P.nr.78/21 i datës 04.02.2021 i lejuar nga përmbartuesi privat Irfan Kërçagu.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.653/22 të datës 20.09.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbartimit Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, ka shfuqizuar në tërësi urdhrin përmbartimor P.nr.78/2021 i datës 04.02.2021 i përmbartuesit privat Irfan Kërçagu, me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e themeltë ankesa e kreditorit, ashtu që të anulohet aktvendimi KPPP.nr.653/22 të

datës 20.09.2023 dhe çështja të kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose ta ndryshoje aktvendimin e shkallës së parë dhe ta refuzojë prapësimin e debitorit

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit mbi bazën e dokumentet të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat e kontabilitetit me nr. K020944, ka lejuar Urdhrin për Përmbartim P.nr. 78/2021, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 762.71 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori KS “Siguria”, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbartimit, me arsyetim se debitori nuk ka legjitimitet që të bëjë pagesën e borxhit sepse me datë 10.07.2020 KS “Siguria” ka dërguar njoftimin B.G. që do të shkëputet kontrata në mënyrë të një anshme sipas nenit 2 të kontratës së lidhur në mes palëve kontraktuese, dhe se që nga data 10.08.2020 lokali në fjalë do të jetë i lirë për shfrytëzim, dhe rrjedhimisht ka theksuar se debitori KS Siguria nuk ka përgjegjësi për pagimin e këtij borxhi. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se kreditori të gjithë konsumatorët e tij i identifikon përmes ujëmatësit dhe shifrës së konsumatorit që nga momenti kur është konsumues i ujit, dhe në rastin konkret në kartelën financiare të konsumatorit nga viti 30.04.2017 është regjistruar konsumatori B.G. SIGURIA Rr. Hajvali I p.nr Fshatrat e Prishtinës, dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë kërkesë të arkivuar në si kreditor që debitori nuk është shfrytëzues i lokalit afarist, dhe nuk ka pasur një njoftim se lokali afarist në adresën Rr. Hajvali, p.nr., Fshatrat e Prishtinës, me shifër K020944, nuk shfrytëzohet më nga debitori. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të pa argumentuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.653/22 të datës 20.09.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbartimit Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, dhe

shfuqizuar në tërësi urdhrin përmbarrimor P.nr.78/2021 i datës 04.02.2021 i përmbarruesit privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarrim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit. Andaj, duke qenë se urdhri përmbarrimor është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbarrimor. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshojë aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitivin e nenit 29, 38 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përmbarrimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me kod K020944, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarrimore, është dokument përmbarrues dhe i përshtatshëm për përmbarrim, për faktin se kartela financiare është lëshuar për periudhën 01.01.2013 deri 03.02.2021, në vlerë totale të borxhit prej 762.71€, andaj kartela financiare, është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarrim, si dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:

ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se kartela financiare e kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore të lartcekura kartelën financiare në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm

në bazë të cilit realizohet përmbarimi, pasi që edhe kartela financiare për periudhën 01.01.2013-03.02.2021 e kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e kreditorit për klientët, që paraqet gjendjen e debi-kredisë së klientit, në pagimin e borxhit në këtë rast për periudhën e lartcekur. Në këtë rast propozimi për përmbarim i iniciuar nga kreditori përmban të dhëna të mjaftueshme të debitorit, dhe nuk është në kundërshtim me nenin 38 par.1 dhe 2 i LPP-së, dhe në anën tjetër asnjë dispozitë ligjore nuk parasheh se ekstrakti nga librat e kontabilitetit, duhet të përmbaj edhe informatat tjera si: numrin e biznesit të debitorit. Gjithashtu nga prapësimi i debitorit shihet se nuk është kontestues propozimi për përmbarim i kreditorit apo ekstrakti si dokument i besueshëm sa përket identifikimit të dhënave të sakta të debitorit.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.78/21 datës 04.02.2021 i lejuar nga ana e Përmbaruesit privat Irfan Kërçagu.

Dhomat e shkallës së dytë pranon pretendimet ankimore se ekstrakti nga librat e kontabilitetit të kreditorit, është dokument i përshtatshëm për përmbarim dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 të LPP-së.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1496/23 datë 03.04.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha